

RAPORTI NR.3 I AUDITUESIT
Mbi Verifikimin e Veprimeve ne Bazen e te Dhenave te
Regjistrit Kombetar te Gjendjes Civile
DHE
Platformen Elektronike te Regjistrimit te
Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

Përgatiti:
Laert Kraja
Audit Teknikien

 1

Lënda : Raport i Auditimit

**Drejtuar : Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve
Komisioneri dhe Nënkomisioneri Shtetëror për Zgjedhje**

Të nderuar,

Në zbatim të vendimit Nr.3 , datë 08.01.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve si dhe të listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025", udhëzimit Nr.2, datë 28.12.2012 të KQZ "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe në sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV), si dhe Vendimin Nr.15 të datës 08.01.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për caktimin e detyrave dhe përgjegjësi të auditëve teknikienë për mbikëqyrjen e veprimeve të realizuara nga KQZ për regjistrin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për kuvend të datës 11 Maj 2025" ju paraqes më poshtë raportin e auditimit të kryer mbi të dhënat e ekstraktit të parë datë 4 Janar 2025, ekstraktit të dytë datë 2 Shkurt 2025 dhe ekstraktit të tretë datë 2 Mars 2025 nga ana e DPGJC dhe listës përfundimtare nga sistemi për votimin e shtetasve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të dërguara nga ana e KQZ drejt DPGJC deri me datë 11.03.2025 i cili ishte dhe afati i fundit i cili i lejonte votuesit e miratuar si votues nga jashtë të ndryshonin zgjedhjen e tyre të cilat ishin kryer deri më datë 04.03.2025 dhe të votonin në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe statistikave përfundimtare mbi aplikimet në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER).

Verifikimet paraprake mbi bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhore e listat e zgjedhësve të gjeneruara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile(RKGJC) në zbatim të "Kodit Zgjedhor",



Raporti Nr. 3 i Audituesit Teknikion

Ligjit "Për Gjendjen Civile" dhe mbi Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë kryer duke përdorur metodën e testimit dhe krahasimit nëpërmjet këmbimeve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.370, datë 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".

Për përmbushjen e misionit të ngarkuar kam vlerësuar metodat dhe parimet e përdorura për kontrollin e dublimeve në listat e zgjedhësve sipas procedurave të parashikuara në aneksin nr.1 të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, datë 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile", respektimin e kriterit ligjor për numrin e zgjedhësve për qendrat e votimit si dhe kriteret e tjera të vendosur në ligj.

Përgjegjësia e audituesit është të verifikojë përputhshmërinë e veprimeve të kryera nga DPGJC dhe KQZ me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, ligjin për "Gjendjen Civile" dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të dhënave të Regjistratit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe Vendimeve dhe Rregullave të miratuara nga KQZ për arkitekturën e Platformës Elektronike të Regjistrimit, përpunimin dhe regjistrimin e të dhënave në Platformën Elektronike të Regjistrimit deri në nxjerrjen përfundimtare të listës së shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



Contents

1. Hyrje	5
2. Baza Ligjore	7
3. Situata e përgjithshme e punës dhe të dhënat bazë paraprake	8
4. Verifikimi i integritetit dhe problematikat në Listën e Zgjedhësve.....	16
5. Administrimi i procesit sipas detyrimeve ligjore	17
6. Opinion	18
7. Shtojca.....	19



1. Hyrje

Ne kuadër të zgjedhjeve, sipas dekretit nr. 399 të Presidentit të Republikës, datë 05.12.2024, do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025 nëpërmjet vendimit Nr.3, datë 08.01.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve si dhe të listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025" është bërë caktimi i auditit teknikien.

Hapat e ndjekur për procesin e auditimit janë në përputhshmëri me përcaktimet e Udhëzimit nr. 2, datë 28.12.2012 të KQZ "Për Miratimin e Rregullave të Veçanta, për Kushtet e Kontratës dhe Kryerjen e Auditimit, nga Auditët Teknikien, për Verifikimin e Veprimeve në Bazën e të Dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) dhe në Sistemin Elektronik të Verifikimit dhe Regjistrimit të Zgjedhësve (SEV)";

Si dhe Vendimin nr.15 datë 08.01.2025 të KQZ " Për caktimin e detyrave dhe përgjegjësi të auditëve teknikienë për mbikëqyrjen e veprimeve të realizuara nga KQZ për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë,

Me qëllim realizimin e këtyre objektivave, puna jonë si auditues teknik është përqendruar në mbledhjen e informacionit të nevojshëm mbi procesin e hartimit të listave të zgjedhësve nga ana e DPGJC dhe funksionimin e sistemit PER të ndërtuar nga KQZ me qëllim regjistrimin e shtetasve shqiptar që ndodhen jashtë territorit shqiptar të cilët shprehin dëshirën për të votuar nëpërmjet postes gjithashtu ndërveprimin e dy institucioneve për të realizuar hartimin e listave për zgjedhësit brenda dhe jashtë territorit sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020, ligjin nr. 118/2020 datë 05.10.2020 dhe ligjin nr. 81/2024, datë 26.07.2024.

Në zbatim të detyrës të caktuar kontrolli i ekstraktit të përbërësve zgjedhor përfshin në përgjithësi:

- Njohjen dhe verifikimi i procedurave të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pranë Ministrisë të Brendshme, Zyrrave të Gjendjes Civile pranë Bashkive dhe Njësive Administrative, si dhe të strukturave të tjera të pushteti vendor të cilat direkt apo indirekt ndikojnë në përgatitjen e listës së zgjedhësve, si dhe ato të kryera nga Komisioni Qendror i zgjedhjeve në

Raporti Nr. 3 i Audituesit Teknikion

përgatitjen e listës së zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

- Verifikimi mbi masat e ndërmarra për sigurimin e integritetit të bazës së të dhënave dhe mbi procedurat e mirëmbajtjes dhe administrimit të sistemeve të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe mbi sistemin e ngritur të Platformës Elektronike të Regjistrimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kryerjen e verifikimeve mbi veprimet e kryera nga shërbimi i Gjendjes Civile të cilat ndikojnë në elementët zgjedhorë, sipas përcaktimeve të nenit 45, të ligjit nr. 10019 me datë 28.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE" i ndryshuar.



2. Baza Ligjore

- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012, ligjin nr. 31/2015, datë 02.04.2015, ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020, ligjin nr. 118/2020 datë 05.10.2020 dhe ligjin nr. 81/2024, datë 26.07.2024.
- Ligji Nr.10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar me ligjin Nr.6/2012, datë 02.02.2012, ligjin Nr.130/2013 datë 25.04.2013, ligjin Nr.134/2016 datë 22.12.2016 dhe ligjin Nr.69/2018 datë 11.10.2018.
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore"
- VKM Nr.365, datë 11.6.2004 "Për krijimin e mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik".
- VKM Nr.673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar me Vendimin e KM Nr.36, datë 24.01.2018, Vendimin e KM Nr.88, datë 14.02.2018 dhe Vendimin e KM Nr.448, datë 26.07.2018.
- VKM Nr. 945, datë 2.11.2012 "Për Miratimin e Rregullores 'Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore'"
- VKM Nr. 710 datë 21 gusht 2013 "Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit" i ndryshuar,
- VKM 222 datë 26.4.2018 "Për miratimin e listës se infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës se infrastrukturave të rëndësishme të informacionit"
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.289, datë 10.09.2020 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë".
- Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike".
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, datë 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".
- Udhëzimit të KQZ-së Nr.2, datë 28.12.2012 "Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe ne sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV)



Raporti Nr. 3 i Audituesit Teknikon

- Vendimit të KQZ nr.15 datë 08.01.2025 " Për caktimin e detyrave dhe përgjegjësi të auditëve teknikienë për mbikëqyrjen e veprimeve të realizuara nga KQZ për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë."
- Vendimit të KQZ nr.194 datë 07.11.2024 "Për rregullat teknike të administrimit, nëpërmjet "PER"-it, të kërkesave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë"

3. Situata e përgjithshme e punës dhe të dhënat bazë paraprake

3.1. Situata e përgjithshme në lidhje me listat e hartuara nga DPGJC

Duhet theksuar që në fillim se me marrjen e detyrës kemi zhvilluar takimin e parë më datë 14 Janar me zyrtarët kryesorë të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, për të siguruar kushtet minimale të punës dhe për të marrë informacionet bazë të nevojshme për zhvillimin e punës sonë. Që në takimin e parë dhe në vazhdim janë kërkuar

1. Përcaktimi i një posti pune pranë DPGJC dhe aksesit në Sistemin Informatik të Regjistrimit Kombëtar të Shtetasve, dhe/apo sisteme të lidhura me të.
2. Kopje zyrtare të Ekstraktit të Listës së Zgjedhësve dhe statistikave përkatëse.
3. Numri i Dublimeve të dyshuara
4. Informacion mbi procesin dhe përditësimin të adresave të shtetasve
5. Informacion mbi procedurat e realizuara në lidhje me reflektimin në Regjistrin Kombëtar të Shtetasve (RKSH) të dekreteve të Presidentit të Republikës për dhënie/marrje shtetësie
6. Statistika mbi të dhënat për QV-të të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore.

Në lidhje me përcaktimin e postit të punës dhe mundësinë për akses në RKGJC është realizuar më datë 15 Janar 2025. Gjithashtu më datë 14 Janar 2025 kemi marrë ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të gjeneruar në datën 4 Janar 2025 dhe si edhe statistikave para nga DPGJC, datë 3 Shkurt 2025 ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhorë të gjeneruar në datën 2 Shkurt 2025.

Bazuar në statistikave të përgatitura nga DPGJC-së mbi ekstraktet e gjeneruara prej tyre, ekstraktit të parë (Ek_1) gjeneruar në datën 4 Janar 2025 dhe ekstraktit të



Raporti Nr. 3 i Audituesit Teknikion

dytë (Ek_2) të datës 2 Shkurt 2025 dhe të tretë (Ek_3) të datës 2 Mars 2025 na janë vënë në dispozicion të dhënat e përgjithshme si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera Ek_1	Vlera Ek_2	Vlera Ek_3
1	Numri i përgjithshëm i shtetasve me të drejtë votimi	3,721,116	3,718,496	3,716,151
	a. Meshkuj	1,879,287	1,877,845	1,876,559
	b. Femra	1,841,829	1,840,651	1,839,592
	c. Votues për herë të parë	114,623	114,630	114,639
2	Numri i përgjithshëm qëndrave të votimit	5,050	5,232	5,198
	a. Numri i Qendrave të votimit mbi limitin (1000 zgjedhës)	147	5	-
	b. Numri i Qendrave të votimit nën limitin (15 - 300 zgjedhës)	13	14	53
	c. QV të vecanta (15-300 zgjedhës)	2	2	2
	d. Numri i qëndrave nga 1 deri në 15 zgjedhës	408	51	6
	Lista zgjedhësve me numer banimi (000 888 999)	21,872	19,643	66
3	Lista e shtetasve 100 vjec të pa përfshirë nga lista	4,536	4,482	4,458
4	Lista e shtetasve (dekriminalizimi) të pa përfshirë nga lista	661	642	696
6	Të pa përfshirë në lista (për shkak të qëndrave jashtë limitit)	159,824	6,332	15,366
7	Numri i zgjedhësve në total të përfshirë në lista	3,561,292	3,662,212	3,525,101



Raporti Nr. 3 i Audituesit Teknikion

Në një vështrim të përgjithshëm nga treguesit e mësipërm rezulton se:

1. Kemi zvogëlim të numrit të shtetasve me të drejtë vote nga Ek_2 në Ek_3 me 2,345 zgjedhës.
2. DPGJC dhe Bashkitë kanë eliminuar mbi 85% të qendrave të votimit me më pak se 15 votues, që si rezultat në Ek_3 janë 6 numri i QV me më pak se 15 zgjedhës kundrejt 51 që ishin në Ek_2. Po të shikojmë QV me më pak se 300 dhe më shumë se 15 votues, 53 QV, kjo rritje ka ardhur nga ndikimi i përfundimi i regjistrimit të zgjedhësve në listën e votuesve nga jashtë territorit.
3. Ka një rritje të numrit të shtetasve të papërfshirë në listën e zgjedhësve me 9,034 shtetas ne EK_3. Në këtë ekstrakt ka shkuar në 15,366. Kjo shifër, duhet të ulet në 0 në listën përfundimtare të zgjedhësve.
4. Vërejmë se problemi i numrit të madh të personave me adresë me kod 000, 888, 999 është ulur ndjeshëm nga ekstrakti i dytë. Tashmë ka vetëm 66 votues me kod 000,888,999.

3.2. Situata e përgjithshme në lidhje me procesin e regjistrimit të votuesve në sistemin PER.

Sistemi PER ka filluar të jetë i disponueshëm për aplikim nga votuesit në datën 11 Janar 2025. Sistemi ka dy ndërfaqe kryesore: Ndërfaqja e aplikimit aksesohet nga Votuesi me anë të aparatit celular me Aplikacion (IOS, Android) ose nëpërmjet kompjuterit (Broëser). Ndërfaqja e operatoreve, të cilët marrin kërkesat e votuesve, i shqyrtojnë ato në bazë të të dhënave që janë ngarkuar nga votuesit dhe marrin vendimin për pranimin e aplikimit ose refuzimin duke u bazuar në vendimin Nr. 11, datë 01.11.2024. Sistemi PER komunikon me RKGJC dhe Identitek nëpërmjet ndërfaqeve online për të verifikuar të dhënat e ngarkuara nga votuesit.

1. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa takime, për marrjen e informacioneve të nevojshme. Nga drejtoria e Votimit nga jashtë pranë KQZ kemi marrë të gjithë dokumentat e kërkuara nga ana jonë. Nga specialistet IT të KQZ ne datën 14.01.2025 është krijuar një përdorues me rolin e Operator për të parë funksionimin e modulit të Menaxhimit të Aplikimeve. Ne datën 27 Janar na janë vënë në dispozicion të dhënat e para mbi aplikimet e votuesve. Ne datën 30 Janar na u dha mundësia e aksesimit të bazës së të dhënave me rolin e audituesit. Cdo listë me të dhënat përkatëse të saj e përcjellë drejt DPGJC na është vënë në dispozicion sipas datave përkatëse 3 Shkurt, 10 Shkurt, 17 Shkurt , 24 Shkurt, 3 Mars , 7



Raporti Nr. 3 i Audituesit Teknikion

Mars lista paraprake e votuesve nga jashtë territorit, dhe 11 Mars ajo përfundimtare.

Gjatë gjithë periudhës që nga fillimi i funksionimit në sistem janë kryer modifikime me qëllim përmirësimin e performancës dhe lehtësimin e regjistrimit të votuesve.

Raporti i kërkesave të bërë në sistemin PER (nr. aplikimeve) pas mbylljes së procesit të regjistrimit dhe shpalljen e listës përfundimtare të votuesve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është si me poshtë:

Kërkesa	Nr
TE SHQYRTUARA	365,166
TE REFUZUARA	119,139

Ndërkohë nr. i zgjedhësve unik sipas miratimit të kërkesave

Zgjedhës unik	Nr
TE MIRATUAR	245,975
TE REFUZUAR	48,180

Koha mesatare e përlogaritur për të cilën operatorët kryejnë shqyrtimin e një kërkesë është rreth 3-4 minuta punë. Koha mesatare nga mbërritja e kërkesës deri në miratim/refuzim përgjatë kësaj periudhe është 46 orë.

Tabela e ndryshimeve:

Kërkesa	Pershkrimi	Statusi
Beni butonin 'Ndihme' me të dukshem.	Butoni duhet të dallohet me shume krahasuar me ikonat dhe/ose butonat e tjere.	Implementuar
Ndryshoni tekstin e telefonit ne	A mund ta ndryshojme kete tekst? ne Telefono (me pagese).	Implementuar
Shtoni nje opsion të ri ne menune e 'Ndihmes'.	Ka nevojë për nje opsion të ri për të drejtuar të tutorialet.	Implementuar

Raporti Nr. 3 i Audituesit Teknikion

Rrotullimi (rotate) i dokumentit	Te kemi mundesine të rrotullojme dokumentin e ngarkuar si prove të adreses (eshte shume e veshtire të shihet perndryshe).	Implementuar
Verifikimi i vendit të lindjes	Vendi i lindjes do të pranoje fjalen e pare ose të dyte ne RKGjC dhe do të informoje perdoruesin ne rast se ai/ajo vendos nje shtet të huaj per të percaktuar vendin e lindjes.	Implementuar
Rritni kohen e OTP	Nga 120 sekonda ne 300 sekonda.	Implementuar
Ndryshimi i arsyeve të refuzimit	6 arsye të reja per refuzim.	Implementuar
Ndryshimi i rendit të vendosjes se emailit dhe telefonit	Perdoruesit do të kerkohet të japin email-in se pari dhe pastaj numrin e telefonit nese nuk kane email.	Implementuar
Ndryshimi i arsyeve të refuzimit dhe riformulimi i disa prej tyre	Ndryshime ne arsyet e refuzimit (7 të tilla).	Implementuar
Ndryshimi i arsyeve të refuzimit dhe riformulimi i disa prej tyre	Ndryshime ne arsyet e refuzimit (saktesim teksti).	Implementuar
Fshehja e kerkimit per operatore	Fshehja e opsionit të kerkimit per operatore ne Modulin e Shqyrtimit të Kerkesave.	Implementuar
Dëshmia e marrëdhënies	Përdoruesit do të jenë në gjendje të ofrojnë një dokument të ri të quajtur dëshmi e marrëdhënies.	Implementuar
Arsye e re e refuzimit	Arsyeja e re e refuzimit, ndryshimi në dëshminë e sjelljes së adresës, ndryshimi i	Implementuar

Raporti Nr. 3 i Audituesit Teknikion

	tekstit në seksionin e adresës dhe shtimi i opsionit të ndihmës së Facebook Messenger	
Shtimi i adresës	Shtimi i adresës mbi dëshminë e adresës për të lehtësuar punën e operatorëve.	Implementuar
Përditësimi i arsyeve të refuzimit	Përditësimi i arsyeve të refuzimit për të lejuar qytetarët të rezervojnë një vend për të marrë ndihmë të drejtpërdrejtë nga KQZ	Implementuar
Heqja miratimi	Heqja e të miratuarit (kërkohet ID e re) dhe e miratuar (sigurohet ID e re) dhe përditësimi i mbi 9000 aplikacioneve në ato statuse duke njoftuar çdo qytetar me sms ose email.	Implementuar
Fshehja e kerkimit per operatoret	Vendosja e kapjes së re të fytyrës për vertetimin e gjallërise.	Implementuar

Nga analiza e të dhënave janë vënë re se 35 votues kanë pasur më shumë se një aplikim të aprovuar. Për rastet e tilla DPGJC ka pastruar dublimet.

Më poshtë mund të gjeni listën e votuesve me statusin përkatës sipas qarqeve në listën përfundimtare të votuesve nga jashtë vendit.

Status	Qarku	Votues
TE MIRATUARA	Berat	15,897
TE REFUZUARA	Berat	2,614
TE MIRATUARA	Diber	9,603
TE REFUZUARA	Diber	2,493
TE MIRATUARA	Durres	25,034
TE REFUZUARA	Durres	5,524
TE MIRATUARA	Elbasan	25,196
TE REFUZUARA	Elbasan	5,926
TE MIRATUARA	Fier	32,559
TE REFUZUARA	Fier	6,283
TE MIRATUARA	Gjirokaster	8,487
TE REFUZUARA	Gjirokaster	1,351
TE MIRATUARA	Korce	20,638
TE REFUZUARA	Korce	4,115
TE MIRATUARA	Kukes	3,970

Raporti Nr. 3 i Audituesit Teknikon

TE REFUZUARA	Kukes	701
TE MIRATUARA	Lezhe	14,761
TE REFUZUARA	Lezhe	2,986
TE MIRATUARA	Shkoder	17,452
TE REFUZUARA	Shkoder	3,677
TE MIRATUARA	Tirane	52,425
TE REFUZUARA	Tirane	8,727
TE MIRATUARA	Vlore	19,953
TE REFUZUARA	Vlore	3,783

Mesatarja e refuzimeve të aplikimeve sipas qarkut ku votojnë është 16,4%. Qarku me përqindjen më të lartë të refuzimeve është Dibra me 20,6%, qarku me përqindjen më të ulët të refuzimeve është Gjirokastra me 13,7%

Më poshtë mund të gjeni sipas statusit përkatës të aplikimit listën e reduktuar vetëm me shtetet me mbi 500 votues të regjistruar në PER.

Status	Te Miratuar	Te Refuzuar	Perqindje
Itali	91,223	21,783	19.3
Greqi	68,386	16,068	19.0
Gjermani	25,499	3,806	13.0
Shtetet e Bashkuara te Amerikës	20,653	1,345	6.1
Mbretëria e Bashkuar	17,227	1,502	8.0
Franca	5,342	698	11.6
Kanada	3,600	196	5.2
Belgjika	2,780	486	14.9
Suedi	2,314	329	12.4
Zvicër	1,261	210	14.3
Austria	1,062	102	8.8
Malta	664	174	20.8
Holland	611	94	13.3
Spanja	577	173	23.1
Irlanda	542	43	7.4
Norvegji	539	83	13.3
...	...	...	...

Nga analiza e të dhënave, vërehen 1483 raste ku aplikues të ndryshëm kanë aplikuar mbi 6 herë në sistemin PER nga i njëjti GeoLocation ose IP(Internet

Raporti Nr. 3 i Audituesit Teknikion

Protocol Number) shërbim i cili u bë aktiv nga ana e KQZ vetëm pas datës 31.01.2025. Ip me numrin maksimal të aplikimeve është 133.

Nr.	IP	Aplikime
1.	Ip_1	133
2.	Ip_2	113
3.	Ip_3	98
4.	Ip_4	61
5.	Ip_5	57
...	...	...

Duke parë dhe numrin e lartë të refuzimeve nga ana e operatorëve më poshtë mund të gjeni të dhënat e arsyeve të refuzimit nga ana statistikore:

Arsyeja e refuzimit	nr
Dokumenti i adresës nuk është ngarkuar i plotë duke mos treguar qartë çfarë lloj dokumenti është.	1,214
Dokumenti i adresës nuk përmban të dhëna të emrit tuaj ose të lidhet me ju.	5,489
Dokumenti i ngarkuar nuk përmban asnjë adresë.	15,552
Ju keni ngarkuar anën e gabuar të dokumentit. Nuk keni ngarkuar anën që përmban adresën.	5,191
Nuk keni ngarkuar një dokument që të vërtetojë adresën që keni deklaruar në PER.	14,020
Të dhënat e adresës në dokumentin që keni ngarkuar nuk janë të lexueshme për shkak se ai nuk është ngarkuar i qartë.	566
Të dhënat e adresës që përmban dokumenti që keni ngarkuar nuk përputhen me adresën që ju keni deklaruar në PER.	9,148

Gjithashtu vërejmë se 48,183 votues unik kanë aplikuar dhe nuk kanë arritur të regjistrohen në listën e votuesve që do të votojnë me postë. Ndëkohë kemi dhe 319 raste votuesish që kanë provuar mbi 4 herë të regjistrohen, por janë refuzuar.



4. Verifikimi i integritetit dhe problematikat në Listën e Zgjedhësve.

4.1. Shtetas brenda së njëjtës familje që votojnë në QV të ndryshme

Bazuar në faktin se listat zgjedhore kanë pasur probleme me ndarjen në QV të ndryshme të votuesve të të njëjtës familje, kemi analizuar Ekstraktin 3 për të identifikuar keta votues.

Nga analiza jonë rezultojnë se në Ek3 janë 49,647 raste të cilat pjestarët e të njëjtës familje votojnë në QV të ndryshme, kemi një rritje nga 26,288 në Ek2 me 23,359 raste. Përsëri vazhdon të jetë problematikë dhe në këtë ekstrakt.

Qarku	Nr. Familje
Berat	2,429
Diber	1,187
Durres	6,869
Elbasan	3,847
Fier	5,587
Gjirokaster	961
Korce	3,781
Kukes	270
Lezhe	2,886
Shkoder	2,142
Tirane	15,018
Vlore	4,670



5. Administrimi i procesit sipas detyrimeve ligjore

Në lidhje me administrimin e procesit të përgatitjes së listës së zgjedhësve konstatohet se:

1. DPGjC ka përgatitur ekstraktin e parë të listës së zgjedhësve më datë 04.01.2025, ekstraktin e dytë më datë 02.02.2025 dhe ekstraktin e tretë më datë 02.03.2025 afate të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.
2. Në përgjigje të kërkesës për informacion mbi rastet e lënies së shtetësisë shqiptare nga ana e qytetarëve dhe si është proceduar për heqjen e tyre nga listat e zgjedhësve nuk na është vënë në dispozicion lista përkatëse, por nga hulumtimi i dekreteve të Presidentit të Republikës së Shqipërisë nga viti 2020 na rezultoi se janë 136 raste të qytetarëve të cilët kanë miratuar me dekret të Presidentit lënien e shtetësinë shqiptare dhe figurojnë akoma në listat e zgjedhësve, ndërkohë nga këto raste kemi 5 qytetarë që kanë aplikuar dhe janë pranuar në listat për votimin nga jashtë.
3. Në përgjigje të kërkesës për informacion mbi rastet kur në zbatim të Nenit 50, pika 2 se nga ana e DPGjC janë identifikuar raste të shkeljeve dhe cilat janë masat administrative të ndërmarra, DPGjC konfirmon se "Nuk janë konstatuar shkelje të cilat të ndikojnë në deformimin e përbërësve zgjedhor të zgjedhësve".
4. Ne pamje të parë janë zbatuar përgjithësisht procedurat e udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.235, datë 10.12.2024 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë", dhe të udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 "Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 "Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike" dhe të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, datë 07.12.2012 "Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile".



6. Opinion

Në përfundim të periudhës së tretë të auditimit referojmë se DPGJC ka publikuar listat në kohën e duhur, kemi një rritje të numrit të votuesve të cilët janë jashtë listës, dhe qendra jashtë limiteve (59 raste) të cilat pritet të korrigjohen në listen përfundimtare dhe votuesit me moshën 100 vjeç e sipër janë përjashtuar nga lista dhe pritet të përfshihen me paraqitjen e tyre në Zyrat e gjendjes civile. Nga DPGJC pritet që në vazhdim të marrë të dhënat nga KQZ dhe Institucionet e veçanta dhe të reflektojë në Listën e Zgjedhësve. DPGJC duhet të ketë parasysh evidentimin e dublimeve në listën e zgjedhësve gjithashtu të evitojë ndarjen e familjeve në qendra të ndryshme të votimit. Duhet parë gjithashtu dhe procedura e heqjes nga lista të qytetarëve të cilët kanë lënë shtetësinë shqiptare pasi kemi akoma qytetar me shtetësi të lënë me dekret presidenti të cilët figurojnë në lista dhe gjithashtu janë regjistruar në PER.

Për sa i përket Sistemit PER, sistemi është një sistem i ri dhe do të duhej të ishte i kolauduar më mirë para se të dilte Live, megjithatë stafi është munduar të korrigjojë problemet dhe ta përmirësojë ndërfaqen gjatë kohës së funksionimit duke realizuar disa ndryshime në sistem. Gjithashtu edhe në si audit kemi hasur vështirësi për të marrë informacion për shkak të problemeve teknike në përgjithësi dhe krijimin e llogarisë për auditin pranë KQZ. Aksesimi i u bë i mundur në datë 30.01.2025. Mbas kësaj date ne kemi patur akses në PER, dhe po në këtë datë është vënë dhe në punë shërbimi Geo-Location IP nga ana e KQZ.

Problematika kryesore e evidentuar në platformën PER konsiston në numrin e madh të refuzimeve në lidhje me dokumentet për vërtetimin e adresave të shtetasve të cilët banojnë jashtë territorit shqiptar dhe nga verifikimet e kryera rezulton se një numër i konsiderueshëm i tyre nuk ka aplikuar më në PER. Përpunimi i kërkesave nga ana e operatorëve të PER ka respektuar kohën e vendosur për përpunimin e tyre.



7. Shtojca

